

VENDIM
Nr. 48, datë 10.11.2023

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS, PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT, PËR
NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-
KANALIZIME FIER SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendimi i KKRR-së nr. 539) dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 28, datë 23.6.2023, “Për shtyrje afati të aplikimit nga shoqëritë ujësjellës-kanalizime për tarifa të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura për vitin 2023”, të ndryshuar (vendimi i KKRR-së nr. 28),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 10.11.2023, pasi shqyrtoi informacionin nr. 385, datë 8.11.2023, të paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe Konsumatorit mbi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

KONSTATOI:

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), me vendimin nr. 10, datë 3.3.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.” ka licencuar Shoqërinë Rajonale UK Fier për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e ujërave të ndotura për një afat 2-vjeçar.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., me shkresën nr. 2269 prot., datë 29.9.2023, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

3. Në zbatim të pikës 1/c, të nenit 13, të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., me shkresën nr. 2452 prot., datë 18.10.2023, me lëndë “Plotësim dokumentacioni” ka dërguar dokumentacionet plotësuese.

4. Në zbatim të pikës 1, të nenit 10, të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, Shoqëria Rajonale UK Fier, në aplikimin për ndryshim të nivelit tarifor, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesa zyrtare drejtuar ERRU-së për ndryshimin e tarifave për shërbimet ujësjellës-kanalizime dhe ITUN;

b) pasqyrat financiare të vitit paraardhës certifikuar nga një ekspert kontabël i autorizuar;

c) plani 5-vjeçar i biznesit, ku të paraqitet edhe programi i investimeve dhe aseteve të reja, i cili do të hartohet në përputhje me formatin e aprovuar në këtë metodologji nga ERRU-ja, që është i detyrueshëm vetëm për grupin e shoqërive që tentojnë të mbulojnë 100% të kostove totale;

d) modeli i aplikimit për nivelin e ri tarifor. Të gjitha tabelat e modelit paraqiten të printuara dhe të firmosura nga shoqëria dhe sipas formatit *excel* të miratuar nga ERRU-ja;

e) organigramë dhe përshkrimet e punës së stafit sipas pozicionit të tyre;

f) aktmarrëveshjet e kredisë midis shoqërisë dhe institucioneve kredidhënëse, në rast se shoqëria është financuar me hua dhe skema e planit mujor të shlyerjeve gjatë viteve të kaluara dhe viteve të ardhshme;

g) mendimin e pushtetit vendor për tarifën e propozuara të shprehura në vendimin përkatës dhe konfirmuar nga prefekti i qarkut për legjitimitetin e tij;

h) vendimi i Këshillit të Administrimit për miratimin e tarifave të propozuara;

i) procesverbali i seancave dëgjimore me publikun, sipas formatit të përcaktuar nga ERRU-ja;

j) subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregullatore të tarifave të propozuara;

k) lejet ose autorizimet për përdorimin e ujit për shoqëritë UK lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të shoqëruara me marrëveshjen ndërmjet shoqërisë UK dhe KBU për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit;

l) raport i detajuar për gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, në të cilën të përshkruhet inventari i aseteve në përdorim të shoqërisë me të dhëna teknike (përmasat, lloji i materialit, vitit të instalimit/ndërtimit), përfshirë dhe prioritetet për zëvendësimin e tyre. Ky material do të hartohet sipas formatit të përcaktuar nga ERRU-ja;

m) relacion analitik ekonomik për vitin paraardhës, si dhe për periudhën rregullatore që kërkohet ndryshimi i tarifave, në të cilën shprehet qartë justifikimi dhe argumentet përkatëse, dhe objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve të punës;

n) në rast se shoqëria aplikon për tarifë shitje uji me shumicë, në kërkesën e saj për tarifa duhet të paraqesë: relacion teknik dhe ekonomik me llogaritjet e tarifës së shitjes së ujit me shumicë, miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese, si dhe aktmarrëveshjet midis palëve shitësblerëse;

o) të ketë shlyer detyrimet për pagesën rregullatore sipas kontratës së nënshkruar midis ERRU-së dhe shoqërisë, dhe në rast të detyrimeve të prapambetura të ketë shlyer sipas marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për shlyerjen me këste të tyre;

p) deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave sipas nenit 26 dhe nenit 46 të kësaj metodologjie.

5. Shoqëria rajonale ujësjellës kanalizime Fier sh.a. nuk ka respektuar akt marrëveshjen nr. 61 prot., datë 8.2.2023, me ERRU-në “Për shlyerjen e pagesës rregullatore të prapambetura sipas riorganizimit në subjekt me kompetenca të përbashkëta dhe vazhdimin e pagesës rregullatore për shoqërinë rajonale ujësjellës kanalizime Fier sh.a.”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se për pjesën tjetër të dokumentacionit aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të pikës 1, të nenit 10, të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

2. Në rast të mosshlyerjes së detyrimit të pagesës rregullatore, sipas aktmarrëveshjes së nënshkruar, Komisioni Kombëtar Rregullator nuk do të miratojë kërkesën e shoqërisë për nivel të ri tarifor.

3. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike për njoftimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani